



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
SPITALI RAJONAL SHKODER

Nr. _____ prot.

Shkoder, me _____.____.2025

MIRATOHET
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SENAD HALLUNAJ

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Me date 23.06.2025 njesia e prokurimit e perbere nga Redona Haxhijaj, Nairda Shpuza dhe Dorentina Kola te ngritur me urdher prokurimi nr 22 date 23.06.2025 në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Rajonal Shkoder** harton proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e prokurimit” Shërbim akomodimi për dy menaxherë turq” **me kod 55110000-4 Shërbime të akomodimit në hotele me fond limit** 4,138,722.00 (katërmilion e njëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njetë e dy) Lekë pa TVSH

Procedura e Hapur e Thjeshtuar”, pasi fondi limit është nën kufirin e ulët monetar për shërbime. kjo lidhur me fondin e ripërllogaritur dhe specifikimet përkatëse është bërë me shkresën nr 1270/1 prot date 03.06.2025 për “Shërbim akomodimi për dy menaxherë turq” **Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, për Spitalin Rajonal Shkoder.**

Njesia e prokurimit lidhur me procedurën ka hartuar kriteret me përmbajtje si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetedeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për

pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b.Sigurimin e ofertes, sipas Shtojces 3 vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës.

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

✓ Nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë të gjitha shtojcat sipas DST-ve të tenderit që janë Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik(Formularin e Ofertës sipas Shtojcës 1,Lista e cmimeve te artikujve sipas shtojces 2).

Kjo shtojce eshte pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituara.

Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se:

1. *Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*

2. *Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të kontratës.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore bazohet sipas ligjit nr.8438 date 28.12.1998 i ndryshuar

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
 - për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
 - **Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *nenin 55 pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.
 - Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:
 - Neni 55,pika 4 germa b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”
-

2.3.2 Vërtetimin, lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik. që vërteton se OE plotëson kushtet higjieno sanitare.

Argumentimi: Ky kriter bazohet në kërkesat e nenit 10 të Ligjit Nr. 7643 datë 12.12.1992 "Për Inspektimin Sanitar" i ndryshuar, dhe në nenin 10.3 të Kreut IV “*Leja Mjedisore dhe Akt Miratimi Higjieno – Sanitar*” të VKM Nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”, ku parashikohet: “10.3. Inspektorati Sanitar Shtetëror, pas ekspertimit higjieno-shëndetësor, lëshon akt-miratim higjieno-sanitar për ushtrimin e veprimtarisë”.

2.3.3 Operoret ekonomik duhet të disponojne 1(nje) hotel ne qytetit te Shkodres jo më larg se 2 km nga vendodhja e Spitalit Rajonal Shkodër vertetuar me nje nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale qeraje ,akt proniesie ose te jene te pasqyruara ne ekstraktin tregtar te operatorit ekonomik pjesemarres.

Argumentimi: Ky kriter bazohet në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.3.4 Çertifikate Kategorizimi lëshuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit “Strukturë Akomoduese” për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese, Kategoria:Hotel.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne mbështetje te ligjit Nr. 93/2015 “Për turizmin” ; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.89, datë 1.3.1993 “Për dhënien e licencave për ushtrimin e veprimtarive turistike”, të Udhëzimit të përbashkët Nr.1, datë 19.5.2003 “Mbi licencimin dhe kontrollin e ushtrimit të veprimtarisë turistike” pika 1 e tij, si dhe të Urdhërit të Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit nr.267, Datë 24.07.2019 “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese” , i ndryshuar, neni 8 i saj.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shtojca 5

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

Hoteli duhet të ofrojë kushtet e mëposhtme:

- ☐ Vendndodhja e hotelit duhet të jetë jo më larg se 500 m nga qendra e qytetit, dhe jo më larg se 2 km nga vendodhja e Spitalit Rajonal Shkodër.
- ☐ Hoteli duhet të mbulojë fjetje në dhoma standarte teke. Arredimi dhe mobilimi i dhomave duhet të ofrojë kushte optimale dhe të kënaqshme për qëndrimin/jetesën.
- ☐ Hoteli duhet të ketë shërbim të sigurisë 24/7 (kamera ose personel sigurimi).
- ☐ Akomodimi duhet të jetë në një dhomë jo më pak se 25 m².
- ☐ Ngrohje dhe ftohje me kondicioner në dhomë dhe secila dhomë të ketë tualet.
- ☐ Pastërtia dhe higjiena janë themelore në të gjitha kategoritë. Ambienti të plotësojë kushtet e higjienës në të gjitha mjediset e brendshme dhe të jashtme të hotelit (dyshemetë, muret, tavanet, mobiljet, dyert, dritaret dhe çdo pajisje tjetër pa dëmtime, njolla dhe shenja të tjera).
- ☐ Të gjithë mekanizmat dhe pajisjet të jenë funksionale dhe në gjendje pune.
- ☐ Hoteli duhet të ofrojë brenda në çmim shërbimin e lavanterisë gjatë periudhës së qëndrimit.
- ☐ Hoteli duhet të ofrojë brenda në çmim mëngjesin, drekën dhe darkën.
- ☐ Të gjitha ushqimet të jenë brenda parametave dhe standarteve të miratuara nga organet kompetente, të jenë të freskëta dhe të cilësisë të parë.
- ☐ Preferohet të përdoret mish viçi, qingji, keci me nënproduktet e tyre.

Afati i lëvrimit të shërbimit është 270 dite nga nënshkrimi i kontrates.

NJËSIA E PROKURIMIT:

Redona Haxhijaj

Nairda Shpuza

Dorentina Kola